

**Programit për Decentralizim dhe Zhvillim Lokal (dldp)
Mbështetje teknike për manaxhimin e mbetjeve urbane
(Prill– Dhjetor 2012)**

PREZANTIM
RREGULLAT, RREGULLORET DHE KONTRATAT E OFRIMIT TË SHËRBIMIT TË MANAXHIMIT
TË MBETJEVE
MUNDËSITË DHE PENGESAT PËR REDUKTIMIN E KOSTOS DHE RRIJTJEN E CILËSISË
SHKODËR
13 NËNTOR, 2012



??? Rregullat dhe rregulloret për mbetjet ???

- A keni hartuar një **rregullore** në lidhje me shërbimin e manaxhimit të mbetjeve?
- A mendoni se kjo rregullore **zbatohet/ndiqet** nga stafi i bashkisë/komunës?
- A mendoni se operatori i shërbimit/ publiku zbaton **detyrimet e përcaktuara** në rregullore?
- A keni përcaktuar një **strukturë (staf)** nga njësi **për monitorimin e zbatimit** të rregullores të shërbimit të mbetjeve?
- A keni raste kur keni **zbatuar masat ndëshkuese** të parashikuara në rregullore ndaj shkeljeve që keni evidentuar?
- Numri penaliteteve** apo gjobave të vendosura për moszbatim të rregullave?
- A mendoni se ka **përmirësime reale në ofrimin e shërbimit** të mbetjeve nga zbatimi i rregullores?

Rëndësia e rregullave dhe rregulloreve për shërbimin e manaxhimit të mbetjeve

- Në përcaktimin e rolit të prodhuesve dhe operatorëve të mbetjeve
- Në hartimin dhe aprovimin e ligjeve dhe rregulloreve ndaj hedhjes pa kriter të mbetjeve dhe për përcaktimin e tarifave për mbetjet
- Në manaxhimin e suksesshëm të mbetjeve, pasi kërkon hartimin e rregulloreve dhe udhëzuesve
- Sigurimi i pjesmarrjes të sukseshme të sektorit privat në shërbimin e manaxhimit të mbetjeve

??? Hartimi i rregullores???

Fakt: Njësi Vendore nuk ka një rregullore për manaxhimin e mbetjeve



Si mund të përgatitet një rregullore për manaxhimin e mbetjeve?

1. Dispozita të përgjithshme
 - Qëllimi
 - Përkufizimet
 - Klasifikimi i mbetjeve
2. Standardet e cilësisë dhe të punës, metodologjitë dhe teknologjitë, procedurat e sigurisë dhe shëndetit për shërbimet e mbetjeve dhe pastrimit

Si mund të përgatitet një rregullore për manaxhimin e mbetjeve?

3. Rregullat dhe detyrimet për prodhuesit e mbetjeve

- Mirëmbajtja e kontenerëve dhe vend-ndodhja e tyre
- Kriteret për vendet e hedhjes së mbetjeve, ndalimi i djegies së tyre
- Kriteret të veçanta për mbetjet voluminoze dhe të rrezikshme
- Kriteret në lidhje me pastrimin e pikave ambulatorë, dyqaneve dhe PGM
- Çështjet që lidhen me faktorët e jashtëm, si parkimi pranë PGM
- Detyrimi për pagesën e tarifës
- Çështje që lidhen me shëndetin publik

Si mund të përgatitet një rregullore për manaxhimin e mbetjeve?

4. Parashikimi në rregullore i drejtave dhe detyrimeve të atyre që manaxhojnë shërbimin e mbetjeve (NJQV/ Sektori privat)

- Veprimet të kryhen vetëm nga kontraktorët e licensuar
- Të përdorim makineri dhe kontenerë të përshtatshëm
- Të përdorin vende të licensuara për depozitimin e mbetjeve/ riciklimin apo recuperimin e mbetjeve
- Regjistrimi i konsumatorëve dhe mbajtja e të dhënave në lidhje me sasinë e mbetjeve që gjenerohen
- Magazinimi i materialeve të riciklueshme
- Parandalimi i problemeve me shëndetin publik

Si mund të përgatitet një rregullore për manaxhimin e mbetjeve?

5. **Tarifat e mbetjeve dhe vjelja e tyre**
 - Hartimi i një rregullore për tarifën e mbetjeve, të cilat përcaktojnë një procedurë për mbulimin e kostos të shërbimit
6. **Parashikimi i programeve për programe ndërgjegjësimit dhe komunikimit me publikun**
7. **Zbatimi dhe Sanksionet**
 - Përcaktimi në rregulloren e sanksioneve dhe gjobave, të cilat duhet të vendosen dhe miratohen nga këshillat vendore
 - Bashkitë dhe komunat duhet të kenë si pjesë të objektivit dhe qëllimit të punës së tyre parimin "ndotësi paguan"


7

Model rregullore për mbetjetet_Komuna Guri i Zi

- 1 • Dispozita të përgjithshme
- 2 • Patrimi i rrugëve shesheve dhe trotuareve
- 3 • Veçimi, sistemimi dhe dorëzimi i mbetjeve
- 4 • Grumbullimi dhe transporti i mbetjeve
- 5 • Vjelja e tarifave
- 6 • Ndalimi, kontrolli dhe sanksionet
- 7 • Marrëdhëniet me publikun dhe bashkëpunimi me organizata jo qeveritare
- 8 • Zbatimi i rregullores


8

??? Zbatimi i rregullores???




9

??? Zbatimi i rregullores???




10

Si mund të forcohet zbatimi i rregullores?



11

Si mund të forcohet zbatimi i rregullores?



12

Si mund të shkruajmë një rast studimor?

Bashkia/ Komuna	
Rasti Studimor nr. _____	
Moduli dhe tema përkatëse e përgjedhur për t'u zhvilluar	
Moduli 1: Organizimi efektiv i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve Temat e rasteve studimore <input type="checkbox"/> Aspektet teknike të organizimit të shërbimit të grumbullimit të mbetjeve urbane <input type="checkbox"/> Manaxhimi i burimeve njerëzore të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve <input type="checkbox"/> Mirëmbajtja e pajisjeve të (kontenierë, kamiona) të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve	Moduli 2: Monitorimi, kontrolli dhe informim komunikimi Temat e rasteve studimore <input checked="" type="checkbox"/> Monitorimi i indikatorëve të performancës të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve <input type="checkbox"/> Monitorimi i zbatimit të objektivave të PLMMN <input type="checkbox"/> Hartimi i një programi informim komunikimi në funksion të ndërgjegjësimit të publikut me çështjet që kanë të bëjnë me manaxhimin e mbetjeve
Moduli 3: Aspektet financiare të shërbimit të manaxhimit të mbetjeve Temat e rasteve studimore <input type="checkbox"/> Si të kontrollojmë më mirë dhe të reduktojmë shpenzimet për shërbimet e mbetjeve <input type="checkbox"/> Si të përmirësojmë të ardhurat e shërbimit të manaxhimit të mbetjeve dhe përmirësimin e normës të mbulimit të kostos	Moduli 4: Rregullat, rregulloret dhe kontratat e shërbimit të mbetjeve Temat e rasteve studimore <input type="checkbox"/> Kontraktimi dhe kontrolli, përgjegjësitë dhe detyrimet e autoriteteve dhe të ofruesve të shërbimit <input type="checkbox"/> Rregullat, rregulloret dhe forcimi efektiv i zbatimit të tyre

Si te shkruajme një rast studimor

Hapat e zhvillimit të rastit studimor

1. Hyrje: Pse hartohet ky model studimor, fokusi i studimit dhe hapat për të arritur qëllimin e tij. (0.5 faqe)

2. Statusi ekzistues: përshkrim i gjendjes apo praktikave ekzistuese sipas fokusit të njërit prej modeleve të mëposhtme: (0.5 faqe)

•Përshkrimi i përgjithshëm i shërbimeve të grumbullimit dhe transportimit të mbetjeve të skemës ekzistuese, organizimit, infrastrukturës, frekuencave dhe specifikimeve, në zbatim të PVMNNU apo ndryshimeve të tij.

•Praktikave të monitorimit të shërbimit, të monitorimit të planit apo të sensibilizimit, edukimit komunikimit apo përfshirjes së publikut, në zbatim të PVMNNU;

•Përshkrim i praktikave ekzistuese të manaxhimit financiar të manaxhimit të mbetjeve.

•Përshkrim i praktikave dhe instrumentave kontraktuale dhe rregullatore në fuqi në zbatim të PVMNNU

3. Vlerësimi i gjendjes ekzistuese: analiza e gjendjes ekzistuese, bazuar në të dhënat e mbledhura nga pyetësori i zhvilluar për secilin modul si dhe në të dhënat dhe rezultatet e testeve të kryera. Psh.testimi i shërbimit të grumbullimit të mbetjeve, etj., krahasimi i gjendjes apo praktikave ekzistuese, rezultateve, etj., me përcaktimet e bëra në plan, objektivat dhe masat e përcaktuara në të apo në krahasim me NjQV e tjera. (1 faqe)

4. Identifikimi i problemeve: duke u bazuar në rezultatet dhe konkluzionet e vlerësimit të gjendjes ekzistuese, praktikave, mungesave apo veprimeve joefikase, etj që lidhen me mosplotësimin e objektivave të PVMNNU apo të objektivave të projektit, bëhet përcaktimi problemeve sipas tematikave të secilit modul. (0.5 faqe)

5. Propozimi i zgjidhjeve të mundshme - bazuar në problemet e evidentuara në pikën e mësipërme, identifikohen dhe propozohen masat, veprimet korrigjuese apo përmirësuese, që mundësojnë zgjidhjen e problematikës së evidentuar apo përmirësimin e objektivave të projektit. Propozimet duhet të marrin në konsideratë kontekstin vendor dhe aftësinë e NjQV-së për të bërë ndryshimet e propozuara. (0.5 faqe)

6. Zbatimi i masave dhe veprimeve: në përfundim, përshkruhet mënyra se si (procesi) dhe kur NjQV parashikon të ndërmarrë veprimet dhe masat e propozuara. Psh. për të ndryshuar nivelin e tarifave aktuale NjQV-ja duhet të kalojë për miratim në Këshillin Bashkiak, ose ky i fundit miraton ndryshimin e organizimit të shërbimit nga publik në privat, etj. (0.5 faqe)